

FILOZOFIA E POLITIKËS GREKE NDAJ LËVIZJES KOMBËTARE SHQIPTARE (GREEK POLICY PHILOSOPHY DEALING WITH ALBANIAN NATIONAL MOVEMENT)

Ledia DUSHKU

Departamenti i Historisë së Kosovës, Instituti i Historisë

Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë, SHQIPËRI

E-mail: *ledia_dushku@yahoo.com*

PËRMBLEDHJE

Politika e jashtme greke u mbështet në Megali -Idenë*. Si pjesë përbërëse e saj, viset jugore shqiptare iu nënshtruan procesit të helenizimit. Dy ishin instrumentet që u përdorën në funksion të tij, kisha dhe shkollat greke. Mëtimi në thelb i së njëjtës trevë, Shqipërisë së Jugut apo Epirit të Veriut, kushtëzoi në marrëdhëniet e Greqisë me Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. U synua të shkaktoheshin pengesa në rrugën e konsolidimit të saj, sepse ky proces ecte në kah te kundërt me atë të helenizimit. Sa më shumë rritej Lëvizja Kombëtare Shqiptare aq më shumë presion ushtronte mbi procesin e helenizimit duke ndikuar në zvogëlimin e rrezes së veprimit të tij në viset shqiptare. Kjo do të thoshte dështim i Megali-Idesë. Në funksion të një politike të tillë, vilajetet e Janinës dhe të Manastirit u mbajtën nën një veprimtari të gjerë vëzhguese, subversive dhe nën ndikimin e propagandës greke. Ky punim synon ti japë përgjigje pyetjeve të tilla si: Cilat ishin mjetet dhe mënyrat që përdori Greqia për të penguar krijimin e një fronti unik të shqiptarëve? Cili ishte qëndrimi që ajo mbajti ndaj kryengritjeve shqiptare? A pati kontakte midis përfaqësuesve të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe zyrtarëve grekë? Nëse po, cilat ishin rrethanat dhe si përfunduan ato?

Fjalë kyçe: *Lëvizja Kombëtare Shqiptare, Megali-*

Idea, Epiri i Veriut, kisha dhe shkollat greke, helenizimi

Key words: *Albanian National Movement, Megali-Idhea, Northern Epirus (Vorio Epir), Greek Church and schools, hellenization*

Qysh nga janari 1844, politika e jashtme e Mbretërisë Greke, u mbështet në Megali Idenë. Ideja e Madhe ishte njëkohësisht platforma mbi të cilën ishte ngritur edhe vetë nacionalizmi popullor grek.

Ajo mbështetej mbi tre boshte kryesore: në trashëgiminë gjuhësore e kulturore të antikitetit grek; në trashëgiminë e kishës Ortodokse dhe në trashëgiminë politike të Perandorisë Bizantine (Frashëri: 45). Mbështetur në këto tre boshte, vi-

*Megali- Idea u legitimua si si vijë të politikës së jashtme greke me fjalimin e kryeministrit grek, Janis Koletis, në 14 janar 1844 në Asambleenë Kombëtare, gjatë diskutimit të nenit tre të Kushtetutës Greke. Si një program afatgjatë, ajo udhëhoqi politikanët grekë drejt një politikbërjeje ambicioze krahasuar me shtrirjen dhe burimet e shtetit grek. Në mbështetje të saj, ata harxhuan energji të shumta, në kurriz të politikës së brendshme dhe mirëqenies së qytetarëve të Mbretërisë Greke. Në nivelin shpirtëror, kuptimet e fshehura të Megali Idesë, u bënë një mit, një ideoprogram me karakteristika të fiksuara, të afta për të depërtuar dhe modeluar një shtrirje të qëllimeve greke, të cilat madje vepronin edhe në subkoshiençë.



Harta e Greqisë, që përfshin edhe territoret shqiptare nën emrin e Epirit të Veriut.
Zona me ngjyrë të zezë tregon territoret e pretenduara nga M. Venizellos në Konferencën e Parisit

set jugore shqiptare u përfshinë në programin e pretendimeve greke. Kjo përligjej me faktin se në antikitet në jug të Shqipërisë së sotme kishin lulëzuar koloni helene, të cilat kishin përdorur gjuhën dhe kulturën greke. Më vonë këto territore ishin administruar nga Perandoria Bizantine dhe kishin në përbërje të tyre popullsi ortodokse që në Perandorinë Osmane varej nga Patrikana e Stambollit.

Dy ishin qëllimet e Megali Idesë: të çlironte "greqët e robëruar" nga sundimi osman dhe të unifikonte "tokat që banoreshin prej tyre" në një Mbretëri të vetme (Kofos: 17; Mazower: 73). Sipas Megali Idesë, Mbretëria Greke mund të zgjerohet në dy drejtime, përgjatë jugut në ishujt e Egjeut e Kretë, dhe përgjatë veriut në Thesali, Maqedoni dhe Epir (Stavrianos: 469). Ideja e Madhe do të vihej në jetë nëpërmjet kombinimit të rrugës ushtarake me atë kulturore. Rruga ushtarake

parashikonte luftë të hapur me Perandorinë Osmane e kombinuar kjo me kryengritje çlirimtare në zonat që pretendoheshin se ishin greke. Rruga kulturore në dallim nga e para ishte paqësore dhe synonte helenizimin e popullsisë së krishterë ortodokse. Ajo u përdor fuqishëm dhe në mënyrë të vazhdueshme sepse i shkonte për shtat dobësisë ekonomike e ushtarake të Mbretërisë Greke dhe politikës së Fuqive të Mëdha, për ruajtjen e statuskuosë.

Mbi popullsinë shqiptare ortodokse, veproi procesi i helenizimit (*Arkivi i Institutit të Historisë* (më tej *AIH*), A-IV-351; Nikolaidha: 87-107). Synimi i tij ishte asimilimi kulturor i saj, thellimi i dallimeve mes saj dhe popullsisë veriore për të penguar unitetin mes tyre, duke synuar në të ardhmen, bashkimin e saj me Mbretërinë Greke. Helenizimi në viset jugore shqiptare u lidh direkt me Kishën Ortodokse dhe shkollat greke. Përp-

jekjet u bënë nga veprimtarë grekë, pro grekë dhe luajalistë të Patrikanës. Të udhëhequr nga interese financiare, vizione irredente, apo ndjenja fetare, ata shërbyen përpos të tjerave edhe për të shndërruar një pjesë të banorëve të krishtere të vilajetit të Janinës dhe Manastirit në një grup luftarak, të përgatitur për të luftuar në mënyrë aktive në dobi të bashkimit të tyre me Greqinë. Në funksion të një politike të tillë u përdorën termat unifikues ideologjikë si “gjaku i përbashkët” apo “feja e përbashkët”.

Ky proces u lehtësua edhe nga karakteri i shtetit në Perandorinë Osmane si dhe nga politika që Sulltan Abdyl Hamiti ndoqi ndaj shqiptarëve. Duke dashur të ndalojë humbjen e territoreve të Perandorisë, sulltani synoi t'i kthente shqiptarët në një barrikadë të hekurt në Ballkan. Mbështetur në ideologjinë shtetërore të islamizimit, ai vendosi ta bëjë këtë vetëm me shqiptarët myslimanë dhe jo me të gjithë komunitetin etnik, duke lënë shqiptarët ortodoksë nën ndikimin e helenizimit. [Për më shumë mbi karakterin e shtetit në Perandorinë Osmane dhe politikën e sulltanit ndaj shqiptarëve shih Gawrych]

KISHA ORTODOKSE

Administrimi i Perandorisë Osmane bëhej në mënyrë të centralizuar. Për të siguruar bashkimin dhe harmoninë e popujve të Perandorisë, Porta duhej të merrte parasysh traditat e tyre. Por, një gjë e tillë nuk ndodhi. Trashëgimia e popujve nuk u njoh dhe nevojat e tyre lokale nuk u morën parasysh. Ligjet e përpiluara, nuk u bazuan as në karakteret e zakonet e popujve dhe as mbi mundësinë dhe aftësinë e vendit (AIH, A-IV-422, Kujtimet e Syrja Vlorës: 14).

Perandoria Osmane funksionoi si një shtet islamik, në të cilën dallimi midis popujve bëhej mbi bazën e fesë. Vetë sulltani shprehej se “themeli shoqëror dhe baza e politikës është krijuar në bazë të fesë” (Gawrych: 18).

Ideologjia zyrtare dhe gjuha e vendit bënin fjalë për “unitetin e fesë islame dhe të shtetit otoman”. Kështu shteti dhe feja sundonin bashkarisht. Administrimi i popullsisë mbështetej në sistemin e miletit, bazë klasifikuese e të cilit ishte feja. Në një administrim të tillë myslimanët i përkisnin

miletit me të njëjtin emër, ndërsa të krishterët ortodoksë i përkisnin miletit rum. Mileti rum përfshinte popullsi të krishterë ortodokse, të shpërndarë në territore të ndryshme të Perandorisë. Ata drejtoheshin nga Patrikana Ikumenike Ortodokse. Pozita e saj në Perandori ishte e rëndësishme sepse krahas funksioneve shpirtërore sulltani i la dorë të lirë të merrte pjesë dhe të luante një rol në politikën dhe administrimin e nënshtetasve të saj ortodoksë (Mazower: 70). Patrikana administronte kështu si kishat ashtu edhe shkollat e kësaj popullsie.

Nga ana tjetër, roli i saj në mbrojtjen e besnikërisë ortodokse dhe puna në mbështetjen e letërsisë greke, edukimit dhe civilizimit gjatë sundimit osman, tregoi se Patrikana ishte e vlefshme edhe në zhvillimin e nacionalizmit modern grek, duke shërbyer si komponenti më i rëndësishëm i helenizimit (Psomiades: 16). Në sajë të ndikimit që fanariotët kishin brenda saj, ajo mbështeti helenizimin gradual në Perandorinë Osmane duke synuar transformimin e saj në një shtet greko-turk (shih: Stavrianos: 279-283; Tudorova: 55-74). Promovimi i marrëdhënieve miqësore midis Mbretërisë Greke dhe Perandorisë Osmane, mendohej prej drejtuesve grekë të Patrikanës se do t'i siguronte grekëve lehtësira në zhvillimin dhe përhapjen e programit kulturor dhe arsimor. Klima paqësore, mundësonte gjithashtu edhe helenizimin e një numri të vogël të popujve jo grekë (Kofos: 17).

Themelimi i shteteve kombëtare në Gadishullin e Ballkanit, ngushtoi rrezen e veprimtarisë së Patrikanës duke dobësuar edhe fuqinë e saj. Me forcimin e lëvizjeve fetare me karakter kombëtar, ajo nisi ta humbiste karakterin ekumenik. Dalëngadalë ajo po kthehej në një kishë ortodokse greke. Veprimtaria e saj në mbështetje të helenizimit të besnikëve dhe përkrahësve të saj, u përforcua. Nëpërmjet fesë u synua të barazohej ortodoksia, ndjenja dhe orientimi kombëtar grek. Patrikana shërbeu kështu si një mekanizëm homogjenizimi dhe asimilimi i popullsisë ortodokse.

Popullsia shqiptare ndiqte tre besime fetare: myslimane, ortodokse dhe katolike. Ajo nuk u njoh nga sulltani si kombësi më vete. Asnjëri prej këtyre tre besimeve, si nga fryma politike, nga sfera kulturore dhe nga gjuha e liturgjisë, nuk

kishte karakter shqiptar. Shqiptarët hynin në tre hierarki të ndryshme dhe jeta shpirtërore e tyre ishte e lidhur dhe sundohej nga tri institucione fetare, tri shkolla dhe tri kultura.

Shqiptarët ortodoksë ishin nën autoritetin e Patriarkut ikumenik, i cili kontrollonte shkollat dhe kishat ortodokse në viset shqiptare. Gjuha greke shërbente si mjeti i vetëm për mësimin nëpër këto shkolla dhe për faljen nëpër kisha. Mohimi i ekzistencës së kombësisë shqiptare i krijoi lehtësi veprimtarisë së institucioneve fetare. Me forcën e fesë, privilegjeve, propagandës, Patrikana kontribuoi në shkishërimin (Nikolaidha: 102) apo bashkëpunimin për eliminimin fizik të personaliteteve shqiptare me peshë në jetën kulturore apo politike (Gawrych: 137); në shtimin e numrit të shkollave greke; në detyrimin e popullsisë shqiptare për frekuentimin e tyre dhe mosndjekjen e shkollave shqipe; në procesin e infiltrimit në shkollat greke të lutjes fetare. Këtij procesi me kalimin e kohës ju dhanë gjithnjë e më shpesh elementë me ngjyrë dhe përmbajtje të thellë politike, duke shkelur programin laik që këto shkolla duhet të kishin. Patrikana e Stambollit ndikoi kështu edhe në përhapjen e ideve ultragreke duke shfrytëzuar strukturën shumë fetare të shqiptarëve në viset jugore shqiptare (Raça: 212).

Në misionin e saj Patrikana bashkëpunoi ngushtë me qeverinë greke. Bashkëpunimi u bë në funksion të mbrojtjes së helenizmit. Nga ana e tyre u bënë përpjekje për një kuadër programesh defensive, për neutralizimin jo vetëm të veprimtarisë së Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, por edhe të propagandave të tjera që vepronin në viset shqiptare, të cilat nuk i vinin përshtat përpjekjeve helenizuese (Nikolaidhu, 1978: 102, 156, 171).

Patrikana bashkëveproi edhe me Portën e Lartë. Të vetëdijshme për marrëdhëniet që ekzistonin midis shqiptarëve myslimanë dhe atyre të krishterë, të cilat forcoheshin nga gjuha e përbashkët dhe ndjenja kombëtare (Skëndi: 130), ato mbështetën njëra-tjetrën në politikën e dallimit dhe ndarjes midis tyre. Së bashku, iu kundërvunë kërkesave të përsëritura të shqiptarëve për hapjen e shkollave shqipe dhe mësimin të gjuhës amtare atje. Shpesh herë Patrikana dhe autoritetet vartëse të saj nxitën autoritetet osmane për të penguar hapjen e zgjer-

imin e shkollave shqipe; veprimtarinë e shoqërive shqiptare për mësimin e shqipes dhe autoqefalinë e kishës shqiptare .

SHKOLLA NË GJUHËN GREKE

Mosnjohja e kombësisë shqiptare, bënte që popullsia të mos gëzonte shumë nga atributet që kishin kombësitë e njohura në Perandorinë Osmane. Një nga këto ishte edhe e drejta për tu arsimuar në gjuhën amë. Politika arsimore e ndjekur nga Perandoria Osmane ia lehtësoi punën në terren zbatimit të vijës politike greke. Ajo krijoi mjedisin e përshtatshëm për hapjen dhe përhapjen e shkollave në gjuhën greke, në vilajetin e Janinës dhe të Manastirit ku kishte popullsi ortodokse. Në këto vilajete, popullsia vendase shqiptare që frekuentonte besimin ortodoks, u arsimua në mënyrë legale në gjuhën greke. Në këtë mënyrë, u krijua një zonë në të cilën popullsia shkollohej në të njëjtën mënyrë sikurse edhe popullsia e Mbretërisë Greke. Qeveria greke nuk hezitoi të paguante një pjesë të mësuesve të shkollave greke në viset shqiptare. Në ushtrimin e një praktike të tillë ajo nuk hasi pengesa nga autoritetet osmane (Nikolaidhu, 1978: 103).

Gjatë shekullit XIX veçori e politikës së shtetit grek ishte shtimi i numrit të shkollave greke, përhapja e tyre drejt veriut madje edhe në zona etnikisht heterogjene më popullsi të përzier shqiptare, greke e vllahe (Raça: 81). Në funksion të kësaj politike u vunë edhe shoqatat për përhapjen e kulturës greke. Ato funksionin si bashkime kulturore dhe edukuese, që merrnin përsipër të themelonin dhe të financonin shkollat greke, të mbështesnin Kishën Ortodokse duke kontribuar kështu në mbrojtjen e aspiratave kombëtare greke (Kofos: 31).

Në viset shqiptare të vilajetit të Janinës dhe të Manastirit, një rol të rëndësishëm luajti "Shoqata për Përhapjen e Kulturës Greke" me qendër në Athinë. Ajo u krijua më 1893 dhe kishte kompetenca të gjera. Nëpërmjet ngritjes së ndërtesave të reja shkollore, furnizimit të tyre me libra dhe mjete mësimore, të hollat e përdoruara, Shoqata kontribuoi në "mbjelljen e farës së re greke" dhe praktikisht kushtëzoi shkombëtarizimin e popullatës ortodokse shqiptare në mënyrë që me kohë të

arrihej asimilimi i tyre (Kofos: 128-129). Në fillim të shek. XX numri i shoqatave u rrit. Ato u krijuan jo vetëm brenda Mbretërisë greke por edhe në diasporë (Sakellariu: 309-310).

Duke marrë përmasa të gjera në viset jugore shqiptare, gjithë rrjeti i shkollave greke synoi të mobilizonte vetëdijen kombëtare greke dhe ndjenjën e gjithë ortodoksisë. Vëzhgues perëndimorë konfirmonin epërsinë e përgjithshme të shkollave greke në vilajetin e Janinës (Gawrych: 141). Nëse në shek. XVI kemi një shkollë greke në Manastirin e Shën Naumit, në shek. XVIII kemi shkolla në Korçë, Zagori dhe Himarë. Pas mesit të këtij shekulli, numri i shkollave greke në këto zona arin në 200. Në fillimin e viteve '70 të shek. XIX në viset jugore deri në Shkumbin funksiononin 320 shkolla, në vitin 1882 vetëm në vilajetin e Janinës, kishte 643 shkolla greke për djem e mikse me 736 mësues dhe 22 shkolla për vajza me 40 mësuese. Në fund të shek. XIX në viset shqiptare kishte më shumë se 1000 shkolla greke (*Historia e Shqipërisë*, 2002: 248). Të gjitha këto shkolla për nga plani dhe programi i tyre funksiononin si shkollat në Mbretërinë Greke, në frymën më të kulluar të patriotizmit grek (Raça: 129). Nëpërmjet arsimit u kultivua tek ata që ndiqnin shkollat edhe pushteti shpirtëror i rezistencës. Për më tepër sistemi shkollor krijoi një infrastrukturë organizuese jo vetëm për propagandën kombëtare greke por edhe për futjen e mëvonshme të andartëve greke në viset që pretendoheshin nga Greqia (Karakasidi: 161).

Nga ana tjetër, mungesa e shkollave në gjuhën shqipe ndikoi direkt në ngadalësimin e formimit të ndërgjegjes kombëtare shqiptare. Në këto kushte shkollimi në gjuhën greke theksoi vështirësitë që qëndronin në rrugën e unitetit të shqiptarëve (Swire: 55).

MBRETËRIA E GREQISË PËRBALLË

LËVIZJES KOMBËTARE SHQIPTARE (LKSH)

Krijimi i shteteve kombëtare dhe fuqizimi i lëvizjeve nacionale, solli ndryshimin e realitetit në Ballkan. Tanimë shtetet e reja dhe lëvizjet kombëtare të popujve ballkanikë synonin shkollën në gjuhën amë dhe kishën kombëtare. Në këtë kuptim edhe Lëvizja Kombëtare Shqiptare nuk

bëri përjashtim. Qëllimi final i saj ishte çlirimi nga sundimi osman dhe bashkimi i viseve shqiptare në një shtet të vetëm shqiptar. (*Historia e Shqipërisë*, 2002: 18).

Mbretëria Greke, duke pas kaluar përpara Shqipërisë një përvojë të tillë, mund të shërbente shumë mirë si një udhërrëfyese për të. Por, marrëdhëniet e saj me LKSh-në u kushtëzuan nga Megali-Idea. Shkrija në një e nacionalizmit shtetëror të mbaratur nga qeveria me atë jo shtetëror të mbaratur nga populli, e bënte nacionalizmin grek më agresiv (Hobsbaum: 92). Fakti që Mbretëria Greke mëtonte në thelb, atë që sot njihet si Shqipëri e Jugut apo Epir i Veriut (Kondis: 40), ndikoi negativisht në marrëdhëniet mes shqiptarëve. Politika e ndjekur nga Greqia u bë një pengesë e qëllimshme si në përhapjen e rezistencës shqiptare në viset jugore ashtu edhe në bashkimin e trevave shqiptare në një shtet të vetëm. Nga ana tjetër, këmbëngulja greke për aneksimin e tyre, kontribuoi në procesin e kundërt, atë të zgjimit shqiptar. Politika e ndjekur prej saj ndërgjegjësoi LKSh-në të bashkërendonte veprimet për t'i bërë ballë një politike të tillë.

Greqia me përvojën e saj të pasur arsimore e kulturore, me shkollat dhe universitetin e saj dha një ndihmesë të madhe në shkollimin e shqiptarëve, të elitës që zuri poste të rëndësishme në administratën osmane, që udhëhoqi lëvizjen për pavarësi dhe që pas themelimit të shtetit të lirë shqiptar mori postet drejtuese të tij. Por ajo ndikoi negativisht duke i konsideruar shkollat greke në viset shqiptare si të vetmet që duhet të kishin legjitimitetin atje. Greqia duke mbështetur dhe motivuar politikën osmane, nuk lejoi madje pengoi konsolidimin e arsimit dhe kulturës në gjuhën shqipe.

Mbështetur nga sa më sipër, politika greke synoi të shkaktonte pengesa në rrugën e konsolidimit të LKSh-së, forcimi i së cilës ndikonte drejtpërdrejt në ecurinë e helenizimit dhe të ardhmen e pretendimeve greke. Sa më shumë rritej Lëvizja Kombëtare Shqiptare aq më shumë presion ushtronte ajo mbi procesin e helenizimit duke ndikuar në zvogëlimin e rrezes së veprimit të tij në trevat shqiptare. Antagonizmi midis tyre mori forma edhe më të mprehta veçanërisht pas Kongresit të Berlinit. Në Ballkan, vendimet e tij

u konsideruan si një rregullim provizor i situatës dhe si një pikënisje për arritjen e zgjidhjes përfundimtare të çështjeve kombëtare. Në këto kushte, çdo kombësi në gadishull synoi të siguronte sa të ishte e mundur më shumë avantazhe, përpara zgjidhjes përfundimtare të Çështjes Lindore. Në këtë rast grekët dhe shqiptarët nuk bënë përjashtim. Antagonizmi midis tyre filloi me veprimtari propagandistike dhe arriti kulmin me aktivitetin e çetave të armatosura.

Në përligje të qëllimeve helenizuese, qeveritë greke adaptuan një politikë që e vinte theksin në veçimin e popullsisë shqiptare jugore nga ajo veriore. Prej saj u përdorën mjete dhe mënyra të ndryshme për të mos lejuar krijimin e një fronti unik mes tyre, duke shfaqur hapur pretendimet ndaj territoreve jugore. Politika greke u përpoq:

Së pari, të organizonte në vilajetet e Janinës dhe të Manastirit veprimtari të gjerë vëzhguese dhe subversive. Promotorë të kësaj veprimtarie, përveç shkollave dhe kishave ishin edhe konsullatat greke (Gawrych: 36), të cilat vepronin nga Arta në Shkodër. Ato funksiononin jo vetëm si qendra kulturore dhe arsimore, por dhe si vende ku shërbimi i fshehtë organizonte mbledhje dhe ku thureshin intriga diplomatike (Gawrych: 140). Një veprimtari e tillë bënte që veçanërisht vilajetet jugore shqiptare, të cilat kishin edhe numrin më të madh të konsullatave, të ishin jo vetëm nën influencën kulturore, arsimore e fetare por edhe atë politike të Athinës. Pas viteve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, veprimtaria e konsujve u masivizua në funksion të nxitjes së urrejtjes së popullatës ortodokse si greke ashtu edhe shqiptare ndaj shqiptarëve myslimanë (Raça: 211). Duke iu trembur ndikimit të Austro-Hungarisë, Rumanisë dhe më vonë Italisë, diplomacia greke synoi t'i mbante vilajetet jugore shqiptare larg ndikimit të tyre (Shih për më shumë Nikolaidhu: *AIH*, A-IV-422; Xhufi: 430).

Së dyti, ta mbante vilajetin e Manastirit dhe veçanërisht atë të Janinës nën ndikimin e propagandës. Një rol të rëndësishëm këtu luajti shtypi dhe publicistika greke. U organizuan fushata të vazhdueshme dizinformuese, të lidhura ngushtë me mbarështimin e tezave larg të vërtetës. Njëpër një shkrimeve synohej të promovohesh teza

se shqiptarët nuk ishin në gjendje të zgjoheshin, se "LKSh ishte një lëvizje turmash fanatikësh islamikë dhe shqiptarët nuk mund të formonin një komb, pasi ata ishin turq" (Buda: 10). Publicistika synoi përpos të tjerave të legalizonte pretendimet greke në dëm të atyre shqiptare. Ekzagjerimet greke në përbërjen e popullsisë dhe në pretendimet territoriale sollën një kundërpërgjigje me të njëjtën monedhë nga shqiptarët. Pretendimet e tyre u ngritën fuqishëm mbi të gjithë territorin e vilajetit të Janinës, madje edhe mbi krahina ku elementi shqiptar ishte në pakicë.

Së treti, të pengonte rolin normal të shoqërive shqiptare në diasporë. Në ripërtëritjen kombëtare të popujve të Ballkanit nën sundimin osman një rol të rëndësishëm luajti diaspora. Duke qenë se në viset shqiptare, lëvizja kombëtare zhvillohej në kushte ilegale dhe zbatimi i programit të saj ishte gati i pamundur, një rëndësi gjithnjë e më të madhe mori veprimtaria e diasporës shqiptare (*Historia e Shqipërisë*, 2002: 240). Koloni shqiptare u krijuan në Rumani, Bullgari, Egjipt, Amerikë etj. Dalëngadalë ato u organizuan dhe në vitet '80 të shek. XIX u formuan shoqëritë patriotike, të cilat vepronin legalisht dhe në kushte të mira politike. Qëllimi kryesor i tyre ishte t'i shërbenin LKSH-së, duke shtypur dhe shpërndarë libra në trevat shqiptare, duke ndikuar në zgjimin dhe ndërgjegjësimin e shqiptarëve në vendin amë.

Ata që shkronin në kurbet ishin kryesisht të krishterë ortodoksë mbi të cilët kishin vepruar më me forcë praktikata e Portës. Ata vendoseshin në vende të krishtera dhe një pjesë e mirë e tyre u bënë anëtarë dhe aktivistë të shoqërive patriotike të diasporës. Në rini ata kishin ndjekur shkollën dhe kishën greke. Tanimë të vendosur në Rumani, Bullgari, etj., ata filluan ta çlironin veten nga ndikimi kulturor grek dhe ta drejtonin vëmendjen drejt gjuhës dhe kulturës shqiptare. Një kontribut në këtë aspekt dha edhe shtypi shqip i këtyre shoqërive. Ai filloi të shkruante kundër politikës aneksioniste greke të Megali-Idesë dhe kundër grekomanizmit. Shkrime të tilla, shqetësuan qarqet politike greke. Shqetësimi u manifestua edhe në shtypin e përditshëm brenda Mbretërisë Greke. Në faqet e tij lindja e shoqërive shqiptare dhe puna e tyre për lëvrimin e gjuhës shqipe u pa si një hap

që do të çonte në shkëputjen e shqiptarëve nga ndikimi grek. "Gazeta e Athinës" (1885) në artikullin *Konfederata Lindore* shprehej se "lindja e gjuhës shqipe nuk do të thotë gjë tjetër veçse ndarje dhe shkëputje e shqiptarëve prej nesh..." (*Historia e Shqipërisë*, 2002: 243). Më vonë, kur u diskutua mbi karakterin e alfabetit të gjuhës shqipe, qarqet greke ndihmuan propagandën e Turqve të Rinj, për një alfabet me shkronja arabe dhe jo latine (Frashëri: 8). Trysni mbi elementin shqiptar në emigracion ushtruan edhe gazetat e shoqëritë greke në vendet ku vepronte diaspora shqiptare.

Së katërtri, të pengonte përhapjen e kryengritjeve shqiptare të viteve 1910-1912 në viset jugore shqiptare. E bindur se i duhej ndihma e shqiptarëve si aleatë në rast të një koalicioni kundër Perandorisë Osmane, Greqia nuk mundi ta mohonte tërësisht LKSh-në. Duke dashur të veçojë jugun nga pjesa tjetër shqiptare, në momente të veçanta të kryengritjeve shqiptare të fillimit të shek. XX, ajo njohu dhe përkrahu vetëm veprimtarinë e saj në viset veriore. Në përputhje me politikën e saj të jashtme, qeveria greke ishte e gatshme t'u vinte në ndihmë malësorëve në veri, por pa afruar asnjë lloj ndihme në jug. Sipas saj, përfundimi me sukses i një kryengritjeje në jug do t'i cilësonte provincat jugore përfundimisht si shqiptare. Në funksion të një politike të tillë, në korrik të vitit 1910, qeveria greke ra dakord të dërgonte municione në veri dhe t'i ndihmonte ekonomikisht shqiptarët atje (Kondis: 29).

E njëjta gjë ndodhi edhe në mars 1911, kur shpërtheu kryengritja në Malësinë e Mbishkodrës. Greqia kishte bindje se nacionalistët shqiptarë, synonin shtrirjen e kryengritjeve edhe në jug, i cili konsiderohej prej tyre si tokë shqiptare. Ministri i Jashtëm i Greqisë, Griparis, udhëzonte konsullatat greke në vilajetet shqiptare, të përkrahnin vetëm luftën e malësorëve dhe të pengonin shtrirjen e kryengritjes në veri dhe në jug të Epirit. Në momentin kur kryengritja u forcua dhe u zgjerua, qeveria greke ju përgjigj negativisht kërkesës së shqiptarëve për ndihmë. Ajo deklaroi pamundësinë e dhënies së çdo lloj ndihme dhe se shtrirja e kryengritjes në Himarë dhe vise të tjera të Epirit, do të shikohej keq prej saj. E njëjta politike u ndoq edhe për kryengritjen e vitit 1912 (Dushku: 91-105).

Së fundi, të kontaktonte dhe të ndihmonte përgjithësisht eksponentët lokalë shqiptarë duke shmangur kontaktet e drejtpërdrejta me figurat qendrore të LKSh-së

Mendoj se kishte dy faktorë, të cilët ishin nxitës për afrimin e shqiptarëve dhe të grekëve. I pari lidhet me perceptimin që dy popujt kishin rreth *prejardhjes së tyre pellazgjike*, ndërsa i dyti me "*armiqtë dhe interesat e përbashkëta*". Si për shqiptarët ashtu edhe për grekët, Perandoria Osmane dhe Fronti Sllav nën drejtimin e Mbretërisë Ruse, pengonin dhe dëmtonin zgjidhjen e çështjeve të tyre kombëtare.

Megjithëse, qeveria greke hezitoi dhe qe skeptike për një kontakt real dhe të rrafshët me LKSh-në, rrethanat historike nuk i përjashtuan ato. Kontaktet u dëshiruan veçanërisht nga rrethet e moderuara shqiptare dhe u konkretizuan kryesisht në rastet e Krizave Lindore apo në kushtet e dobësisë së Perandorisë Osmane e fuqizimit të propagandës austriake e italiane në viset shqiptare. Nga pikëpamja kronologjike mund të përmendim, kontaktet që u zhvilluan me Abdyl Frashërin, në kuadrin e luftës Ruso-Osmane (1877-1878) për një front të përbashkët kundër Perandorisë Osmane dhe ato që u zhvilluan me Ismail Qemalin në kuadrin e fuqizimit të LKSh-së, kryengritjeve shqiptare dhe dobësisë së Perandorisë Osmane e Lëvizjes së Turqve të Rinj. Por sukseset e tyre qenë të papërfillshme dhe Megali-Idea kushtëzoi përfundimin e tyre.

Në mbyllje, për sa më sipër, po citoj fjalët e kryeministrit grek, Komonduras në prag të bisedimeve me Abdyl Frashërin: "*Unë mendoj se është shumë e rrezikshme të bashkëpunojmë në themelimin e një fuqie miqësore në krahun tonë... Rreziku qëndron pikërisht aty, se ne duhet ta armatosim këtë popull që konteston tokën tonë. Nëse shqiptarët do të revoltohen dhe do t'i okupojnë tokat e diskutueshme, për të dalë më pas me kërkesa të reja, atëherë si do t'iu kundërvihemi ne?" (Kofos, 1982: 354).*

BIBLIOGRAFIA

1. FRASHËRI, K. (1978), "Fillimet e Lëvizjes Kombëtare në Shqipëri", në *Studime Historike*, 1978, Nr. 1.
2. KOFOS, E. *Greece and the Eastern Crisis 1875-1878*, Institute for Balkan Studies, Thessalonica, 1975, f. 17;

3. KOFOS, E. (1982), Greek reaction to developments leading to the Albanian League of Prizren, në "Balkan Studies", no. 2, Thessalonica.
4. MAZOWER, M. (2003), *Ballkani një histori e shkurtër*, Skanderbeg books, Tiranë.
5. STAVRIANOS, L.S. (2000), *The Balkans since 1453*, Hurst Company, London.
6. *Arkivi i Institutit të Historisë - AIH, Instituti i Historisë, Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë.*
7. NIKOLAIDHA, E. (1979), "Qëndrimi i Turqisë ndaj shqiptarëve në lidhje me përhapjen e Megali Idesë në Epir (mesi i shek. XIX)" në *Dodona*, vëll. 8, Janinë.
8. NIKOLAIDHA, E. (1978), *Propagandat e huaja dhe LKSH-ja në krahinën metropolitane të Durrësit dhe të Beratit në fund të shek 19 dhe fillim të shek të 20*, Janinë, në: AIH, A-IV-422.
9. GAWRYCH, G. (2007), *Gjysmëhëna dhe Shqipëria, Sundimi otoman, Islamizmi dhe Shqiptarët, 1874-1913*, Bota Shqiptare, Tiranë.
10. PSOMIADES, H.J. (1968), *The Eastern Question: The last Phase. A study in Greek-Turkish Diplomacy*, Institute for Balkan Studies, Thessalonica.
11. TUDOROVA, M. (1969), "The Otoman legacy in the Balkan", në: *Nationalism in eastern Europe*, University of Washington Press, Washington DC.
12. RACCA, Sh. (1990), *Marrëdhëniet shqiptaro-greke, 1829-1881*, Prishtinë.
13. SKËNDI, S. (2000), *Zgjimi kombëtar shqiptar (1878-1912)*, Tiranë.
14. SAKELLARIOU, M.B. (edited by) (1997), *Greek lands in history, Epirus, 4000 years of greek history and civilization*, Ekdotike Athenon S.A. The Demetrius and Egle Botzaris Foundation, Athens.
15. GRUP AUTORËSH, *Historia e Shqipërisë* (2002), Vëll. II, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Toena, Tiranë.
16. KARAKASIDI, A.N. (2006), *Fushat e grurit, kodrat e gjakut*, Plejad, Tiranë.
17. SWIRW, J. (2005), *Shqipëria, ngritja e një mbretërie*, Dituria, Tiranë.
18. HOBBSBAUM, E. (1996), *Kombet dhe nacionalizmi që nga 1780. Programi, miti, realiteti*, Toena dhe Fondacioni Soros, Tiranë.
19. KONDIS, V. (1997), *Shqipëria dhe Greqia në Shekullin e XX*, Selanik.
20. XHUFU, P. (2006), *Dilemat e Arbrit*, Tiranë.
21. BUDA, A. (1978), "Shqiptarët përballë krizës lindore të viteve 1878-79", në *Studime Historike*, Nr. 1, Tiranë.
22. FRASHËRI, M. (1943), *Nacionalizma shqiptare dhe faktorët ngatërrestarë të brendshëm dhe të jashtëm*, Tiranë.
23. DUSHKU, L. (2007), *Ismail Qemali, Greqia dhe kryengritja shqiptare e vitit 1912* në: AA.NN., *Pavarësia e Shqipërisë dhe sfidat e shtetit shqiptar gjatë shek. XX*. (Përmbledhje studimesh), Klean, Tiranë, 2007, f. 91-105.